



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES**  
**VENDORE**  
**2006-2007**

**RAPORTI I MISIONIT TË VLERËSIMIT TË NEVOJAVE**  
**TË OSBE/ODIHR-it**

6 - 8 nëntor 2006



*Varshavë*  
24 nëntor 2006

## PËRMBAJTJA

<b>I.</b>	<b>HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>II.</b>	<b>PËRMBLEDHJE.....</b>	<b>3</b>
<b>III.</b>	<b>GJETJET .....</b>	<b>5</b>
A.	KONTEKSTI POLITIK .....	5
B.	KUADRI LIGJOR DHE REFORMA ZGJEDHORE .....	6
1.	<i>Sistemi zgjedhor .....</i>	7
2.	<i>Data e mundshme për zgjedhjet vendore .....</i>	7
3.	<i>Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore .....</i>	8
C.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE.....	9
1.	<i>Regjistrimi i zgjedhësve .....</i>	9
2.	<i>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve .....</i>	13
3.	<i>Komisionet e Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore .....</i>	14
4.	<i>Vendet e numërimit .....</i>	15
5.	<i>Certifikatat e lindjes.....</i>	15
D.	MEDIA .....	15
E.	PJESËMARRJA E GRAVE.....	16
F.	VËZHGUESIT NDËRKOMBËTARË DHE ATA VENDAS JO-PARTIAKË .....	17
<b>IV.</b>	<b>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>17</b>
	<b>SHTOJCË: PROGRAMI I MISIONIT TË VLERËSIMIT TË NEVOJAVE .....</b>	<b>18</b>
	<b>RRETH OSBE/ODIHR-IT .....</b>	<b>20</b>

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ZGJEDHJET VENDORE 2006-2007**

**Raporti i Misionit të Vlerësimit të Nevojave të OSBE/ODIHR-it**  
**6 – 8 nëntor 2006**

**I. HYRJE**

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE/ODIHR) ndërmori një Mision të Vlerësimit të Nevojave (MVN) në Republikën e Shqipërisë nga data 6 deri në 8 nëntor 2006. MVN-ja e OSBE/ODIHR-it u kryesua nga Gerald Mitchell, Drejtori i Departamentit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, i shoqëruar nga Gilles Saphy, Këshilltar për Zgjedhjet në OSBE/ODIHR.

Qëllimi i MVN-së ishte të vlerësonte kushtet dhe nivelin e përgatitjes për zgjedhjet e ardhshme vendore në përputhje me angazhimet e OSBE-së, dhe të këshillonte në lidhje me modalitetet e ngritjes së një Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ).

MVN-ja pati takime me Kryeministrin, Ministrin e Punëve të Jashtme, Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), Zëvendësministrin e Brendshëm, si edhe me zyrtarë të tjerë të qeverisë, përfaqësues të partive politike, shoqërisë civile dhe të bashkësisë ndërkombëtare në Tiranë (shih Shtojcën).

OSBE/ODIHR-i i shpreh mirënjohjen Prezencës së OSBE-së në Tiranë për mbështetjen e dhënë gjatë MVN-së.

**II. PËRMBLEDHJE**

Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005 në Shqipëri konfirmuan një prirje të qëndrueshme drejt përmirësimit të zhvillimit të zgjedhjeve dhe të kuadrit zgjedhor, dhe Shqipëria pati një kalim paqësor dhe të rregullt të pushtetit në shtator 2005 nga Partia Socialiste (PS) tek Partia Demokratike (PD). Megjithatë, që atëherë, dialogu politik midis koalicionit qeverisës dhe opozitës është prekur nga një atmosferë gjithnjë e më shumë e polarizuar, mungesë besimi dhe polemika midis udhëheqjeve të partive politike përkatëse.

Kjo situatë pati ndikim mbi përpjekjet për një reformë zgjedhore, dhe mbi vetë përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme vendore. Ndërkohë që kishte një marrëveshje të qartë ndërmjet partive politike për të zbatuar rekomandimet që pasuan publikimin e Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005, përpjekjet vijuese për të trajtuar çështje të reformës zgjedhore në kuadër të Komisionit të Posacëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore (KPPRZ) kanë dhënë pak rezultate. Shqetësim të veçantë përbën hartimi i listave të zgjedhësve për zgjedhjet vendore, proces i cili është vonuar në mënyrë të konsiderueshme, dhe që aktualisht është ndërprerë për shkak të dështimit të miratimit të ndryshimeve të nevojshme në kuadrin ligjor.

Me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare në Shqipëri, më 30 gusht, midis forcave politike u arrit një marrëveshje e cila kishte për qëllim të rigjallëronte përpjekjet e ngadalësuara të reformës zgjedhore. Megjithatë, kjo marrëveshje nuk është zbatuar në të gjitha pikat e saj, dhe mosfunksionimi i vazhdueshëm i KPPRZ-së si dhe vonesat e mëtejshme në përgatitjen e zgjedhjeve vendore mund të venë në rrezik arritjet e njohura të proceseve zgjedhore të Shqipërisë gjatë viteve të fundit. Një shqetësim të veçantë përbën fakti që politikanët shqiptarë, në të dy krahët e spektrit politik, perceptohen se po ringjallin praktika politike të së kaluarës, me mundësinë që interesa partiake mund të ngrihen mbi interesat kombëtare në zhvillimin e zgjedhjeve të ardhshme vendore në përputhje me angazhimet e OSBE-së.

Zgjedhjet e ardhshme do të administrohen nga një administratë zgjedhore në tre nivele: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ), rreth 384 Komisione të Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore (KZQV) dhe rreth 4700 Komisione të Qendrave të Votimit. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, Komisionet e Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore nuk ishin ngritur ende, edhe pse ato duhet të ishin ngritur që më 20 gusht.

Sipas Kodit Zgjedhor, kryetarët dhe anëtarët e këshillave të Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV) zgjidhen me fletë votimi të veçanta në një raund të vetëm votimi. Anëtarët e këshillave të NjQV-ve zgjidhen me përfaqësim proporcional mbi bazën e listave shumemërore dhe të kandidimeve individuale. Kandidati për kryetar NjQV-je i cili merr numrin më të madh të votave në NjQV-në përkatëse zgjidhet kryetar i saj. Ashtu si edhe në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005, numërimi do të zhvillohet në vendet e numërimit dhe jo në qendrat e votimit. Është e nevojshme që të përshtatet kuadri që rregullon vendet e numërimit, me qëllim që të marrë parasysh specifikën e zgjedhjeve vendore.

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, Presidenti i Republikës nuk kishte dekretuar ende datën e zhvillimit të zgjedhjeve, por hapësira ligjore aktuale parashikon se ato duhet të mbahen midis 22 dhjetorit 2006 dhe 21 janarit 2007. Ndërkohë që shumica qeverisëse ka shprehur vullnetin e saj për respektimin e kuadrit ligjor të sipërpërmendur, shumica e partive të opozitës ka ngritur shqetësimin e saj për periudhën kohore dhe ndikimin e kushteve të dimrit mbi procesin zgjedhor.

Të gjitha palët shqiptare me të cilët MVN-ja zhvilloi takime, si edhe bashkësia ndërkombëtare në Tiranë, mirëpritën një angazhim të gjërë nga ana e OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Vëzhgimi vendas i këtyre zgjedhjeve ka të ngjarë të kryhet nga një koalicion organizatash jo-qeveritare vendase.

OSBE/ODIHR-i rekomandon dërgimin e një Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) në Republikën e Shqipërisë për të vlerësuar zhvillimin e zgjedhjeve vendore në përputhje me legjislationin e vendit, angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Me shpalljen zyrtare të datës së zgjedhjeve, OSBE/ODIHR-i do t'u kërkojë shteteve anëtare të OSBE-së të dërgojnë 30 vëzhgues afatgjatë që të fillojnë vëzhgimin e procesit

zgjedhor rreth gjashtë javë përpara ditës së zgjedhjeve dhe 400 vëzhgues afatshkurtër që të dërgohen në të gjithë territorin e Shqipërisë gjatë javës së zhvillimit të zgjedhjeve për të monitoruar procedurat e votimit dhe numërimit.

### III. GJETJET

#### A. Konteksti politik

Në nëntor 2005, ODIHR-i nxorri raportin përfundimtar mbi zgjedhjet për Kuvendin të korrikut 2005 (përfshirë edhe përsëritjen e tyre në fund të gushtit). Raporti përmbante një vlerësim të përgjithshëm pozitiv mbi procesin zgjedhor, i konsideruar në përgjithësi si procesi më i mirë zgjedhor në Shqipëri i zhvilluar deri më sot. Raporti nënvizonte karakterin konkurrues të zgjedhjeve, pluralizmin e mediave dhe profesionalizmin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por tërhiqte vëmendjen për mungesën e vullnetit të mjaftueshëm dhe përgjegjësisë politike të treguar nga partitë e mëdha.

Në 2 shtator 2005, KQZ-ja shpalli rezultatet përfundimtare duke konfirmuar fitoren e Partisë Demokratike (PD) dhe aleatëve të saj ndaj Partisë Socialiste (PS). Qeveria e Dr. Sali Berishës u dekretua nga Presidenti i Republikës në 7 shtator.

Aspektet pozitive të procesit zgjedhor të korrikut 2005 dhe transferimi i mëvonshëm paqësor i pushtetit, rritën perspektivat e procesit të integritimit Euro-Atlantik të Shqipërisë. Në qershor 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit me Bashkimin Evropian.

Që nga viti 1991, sistemi politik shqiptar ka qënë shumë i polarizuar, ku dy partitë politike dominuese, PS-ja dhe PD-ja, kanë konkuruar për marrjen e pushtetit si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor. Mjedisi politik i përgjithshëm në Shqipëri ka prirje të strukturohet rreth këtyre dy forcave politike kryesore.<sup>1</sup>

Në zgjedhjet për Kuvendin të korrikut 2005, Partia Demokratike fitoi 56 nga 140 vendet dhe është partia udhëheqëse e koalicionit qeverisës. Së bashku me aleatët e saj, konsiderohet në gjendje të mbështetet nga një shumicë e mundshme prej pak më shumë se 80 vendesh. PD-ja ka qënë më parë në pushtet nga viti 1992 deri në vitin 1997, vit në të cilin erdhi në pushtet PS-ja.

Pas zgjedhjeve të vitit 1997, në të cilat PD-ja humbi shumicën pas pesë vitesh dominimi, PS-ja e mbajti pushtetin qendror nga viti 1997 deri në vitin 2005. Aktualisht, PS-ja ka 42 vende në Kuvendin e Shqipërisë nga 140 vende gjithsej. Që nga themelimi i saj dhe deri në 1 shtator 2005, Partia Socialiste u udhëhoq nga Fatos Nano, i cili ishte Kryeministër i Shqipërisë nga viti 2002 deri në vitin 2005. Partia Socialiste udhëhiqet aktualisht nga

---

<sup>1</sup> Koalicioni qeverisës përfshin Partinë Demokratike (PD), Partinë Republikane (PR), Partinë Demokratë të Re (PDR), Partinë Demokristiane (PDK), Partinë Bashkimi Liberal Demokrat (PBLD), Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNj) dhe Partinë Agrare Ambientaliste (PAA). Partitë në opozitë janë Partia Socialiste (PS), Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), Partia Socialdemokratë (PSD), Aleanca Demokratike (AD) dhe Partia Demokracia Sociale (PDS).

kryetari i bashkisë së Tiranës Edi Rama, i cili ka filluar reformimin e strukturave të partisë.

Megjithëse ka një pakicë të vendeve në Kuvend, PS-ja dhe aleatët e saj të qendrës së majtë luajnë një rol të fuqishëm në një sërë çështjesh që kërkojnë shumicë të cilësuar. Kjo është e vërtetë veçanërisht në reformën zgjedhore, ose në zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Të dyja këto çështje kërkojnë një shumicë prej 3/5 në Kuvend.

Dialogu politik ndërmjet forcave të koalicionit qeverisës dhe të opozitës ka qënë tensionuar nga një atmosferë gjithnjë e më shumë e polarizuar, mungesë besimi dhe polemika midis udhëheqësve, shpesh të një karakteri personal. Kjo atmosferë ka ndikuar sidomos në përpjekjet për reformën zgjedhore dhe në procesin e zgjedhjeve të ardhshme vendore.

Faktorë të tjerë që kontribuojnë në klimën aktuale politike përfshijnë, ndër të tjera: hartimin dhe zbatimin e një politike anti-korrupsion nga qeveria që me ardhjen e saj në pushtet; debatin për hetimin parlamentar mbi veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm, Theodhori Sollaku; debatet e brendshme në Partinë Socialiste lidhur me organizimin dhe strukturimin e saj; zgjedhjen e ardhshme të Presidentit të Republikës nga Kuvendi. Presidenti Alfred Moisiu u zgjodh nga Kuvendi në verën e vitit 2002, si rezultat i një marrëveshjeje të arritur midis PD-së dhe PS-së. Mandati i tij mbaron në korrik 2007. Nëse Kuvendi nuk do arrijë të zgjedhë Presidentin e ri më një shumicë prej 3/5 të votave pesë herë rresht, duhet të zhvillohen zgjedhje të reja të përgjithshme.

OSBE/ODIHR-i ka vëzhguar zgjedhjet për Kuvendin të viteve 1996, 1997, 2001 dhe 2005, referendumin kushtetues të vitit 1998, si dhe zgjedhjet vendore të viteve 2000 dhe 2003. Është vënë re një tendencë e qëndrueshme drejt përmirësimit të kuadrit ligjor, atmosferës së përgjithshme të fushatës zgjedhore, pasqyrimin në media, rolin e policisë dhe respektimit të institucioneve, veçanërisht pas zgjedhjeve vendore të vitit 2000. Megjithatë, bllokimi politik i strukturave bi-partizane të ngritura për reformën zgjedhore dhe për përgatitjen e zgjedhjeve vendore mund të vënë në rrezik këtë tendencë të përgjithshme pozitive.

## **B. Kuadri ligjor dhe reforma zgjedhore**

Kodi Zgjedhor u miratua nga Kuvendi në qershor 2003, pas ndryshimeve thelbësore në Kodin Zgjedhor që ishte miratuar në maj të vitit 2000, si rezultat i punës konsensuale të komisionit parlamentar bi-partizan për reformën zgjedhore, i bashkë-kryesuar nga PS-ja dhe PD-ja.

Në vitin 2004, OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës nxorrën Rekomandimet e Përbashkëta mbi Kodin Zgjedhor dhe administratën zgjedhore në Shqipëri. Në Rekomandimet e Përbashkëta thuhej se legjislacioni mund të përbënte një bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike, por nënvizonte një sërë çështjesh shqetësuese dhe këmbëngulte që “megjithatë, shkalla, në të cilën çdo ndryshim në ligj mund të ketë një ndikim pozitiv, do të përcaktohet përfundimisht nga niveli i mirëbesimit

dhe vullnetit politik të shfaqur nga partitë politike, institucionet shtetërore dhe zyrtarët përgjegjës për zbatimin dhe respektimin e ligjit”.

Kodi Zgjedhor është ndryshuar më vonë në tetor 2004, janar 2005 dhe prill 2005 si dhe u miratua një ligj i ri për ndarjen e 100 zonave një-emërore. Ndryshimet, disa prej të cilave trajtuan Rekomandimet e Përbashkëta, sollën një sërë ndryshimesh, veçanërisht në lidhje me administratën zgjedhore, hartimin e listave të zgjedhësve, kriteret për përcaktimin e zonave zgjedhore, procesin e numërimit dhe shqyrtimin e ankimeve dhe apelimeve. Në pjesën më të madhe të tyre, këto ndryshime ishin rezultat i punës së komisionit bi-partizan që përfshinte PS-në dhe PD-në.

## **1. Sistemi zgjedhor**

Kryetarët dhe anëtarët e këshillave të Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV) zgjidhen me fletë votimi të veçanta në një raund të vetëm votimi. Anëtarët e këshillave bashkiakë të NjQV-ve zgjidhen me përfaqësim proporcional mbi bazën e listave shumëemërore të paraqitura nga partitë politike dhe koalicionet, si dhe mbi bazën e kandidimeve individuale. Kandidati për kryetar NjQV-je i cili merr numrin më të madh të votave në NjQV-në përkatëse zgjidhet kryetar i saj.

Zgjedhjet e fundit të organeve të NjQV-ve u zhvilluan në 12 tetor 2003, me zgjedhje të përsëritura në pesë data të tjera: 16 nëntor, 7 dhjetor, 14 dhjetor, 28 dhjetor 2003 dhe 25 janar 2004. KQZ-ja mundi të shpallë rezultatin përfundimtar të këtyre zgjedhjeve më 20 shkurt 2004, që shënoi edhe fillimin e mandatit tre-vjeçar të kryetarëve dhe këshillave aktuale të NjQV-ve.

## **2. Data e mundshme për zhvillimin e zgjedhjeve vendore**

Çështja e datës së zgjedhjeve vendore është e një rëndësie themelore, pasi ajo përcakton përfundimisht kohën në dispozicion për disa prej përgatitjeve për zgjedhjet. Koha e zhvillimit të zgjedhjeve vendore është kthyer në një çështje shumë të debatueshme. Partitë pjesë e koalicionit qeverisës, mbi të gjitha Partia Demokratike, janë shprehur se zhvillimi i zgjedhjeve brenda afateve ligjore egzistuese është i një rëndësie themelore. Shumica e partive të opozitës, mbi të gjitha PS-ja, janë shprehur se ato do të ishin në favor të zhvillimit të zgjedhjeve vendore në pranverë. Ato pretendojnë se koha tashmë e shkurtër në dispozicion për përgatitjen e zgjedhjeve, si edhe kushtet e vështira klimaterike, do të vinin në rrezik cilësinë e procesit.

Mandati aktual i organeve të NjQV-ve mbaron në 20 shkurt 2007. Kjo datë lidhet me shpalljen më të fundit të rezultateve të zgjedhjeve vendore 2003-2004 në një sërë NjQV-sh. Kodi Zgjedhor parashikon që zgjedhjet vendore zhvillohen “60 deri 30 ditë përpara mbarimit të mandatit”. Kodi Zgjedhor parashikon gjithashtu që dekreti i Presidentit për shpalljen e datës së zgjedhjeve duhet të nxirret jo më vonë se 75 ditë përpara mbarimit të mandatit.

### 3. Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore

Ndryshimi i Kodit Zgjedhor kërkon një shumicë prej 3/5 të Kuvendit (84 nga 140 vendet), pjesa më e madhe e organeve vendimmarrëse që merren me zgjedhjet janë bi-partizane (ose shumë-partiake), dhe përjasja e përgjithshme deri tani ka qënë të synohet drejt marrjes së vendimeve konsensuale.

Ashtu siç ka ndodhur edhe për përgatitjet e zgjedhjeve vendore të vitit 2003 dhe zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2005, në fund të vitit 2005 u vendos të ngrihej një Komision i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore (KPPRZ) me qëllim kryerjen e dy proceseve të njëkohshëm dhe të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

- Procesi i një reforme zgjedhore me shtrirje të gjërë dhe afatgjatë, bazuar në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it të përmëndura në Raportin Përfundimtar mbi zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005;
- Ndryshimet në Kodin Zgjedhor lidhur me përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme vendore.

Forcave politike iu deshën disa muaj që të binin dakort mbi përbërjen dhe procesin e vendimmarrjes në KPPRZ. Ky i fundit zhvilloi mbledhjen e tij të parë në 23 maj 2006<sup>2</sup> dhe iu dha një mandat tre mujor i cili përqëndrohej në zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. KPPRZ-ja u ndihmua nga një Grup Ekspertësh Teknikë (GET).

Përgjithësisht, edhe pse mandati i KPPRZ-së u rinovua disa herë – zgjatja e fundit përfundoi në 14 nëntor<sup>3</sup>, pa arritur rezultat – si procesi i reformës zgjedhore ashtu edhe përgatitjet për zgjedhjet vendore u penguan vazhdimisht dhe janë ende, në kohën e përgatitjes së këtij raporti, duke përjetuar vonesa dhe bllokime në një sërë çështjesh kryesore. Këtu përfshihen përgatitja e listave të zgjedhësve për zgjedhjet vendore, përbërja e komisioneve zgjedhore, data e zgjedhjeve të ardhshme vendore, sistemi i vendeve të numërimit, ankimet dhe apelimet, etj.

Procesi i ankimeve dhe apelimeve është komentuar në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005 dhe mbetet një çështje shqetësuese. Në veçanti, ai duhet të përdoret nga subjektet zgjedhore si një rrugë për të arritur zgjidhje ligjore, por jo të keqpërdoret me qëllim vonimin pa fund të rezultateve, siç ka ndodhur në të kaluarën.

---

<sup>2</sup> Një Komision i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore ishte ngritur më parë nga Kuvendi më 18 janar 2006 për një periudhë tre mujore. Megjithatë, ky Komision nuk u mblodh asnjëherë.

<sup>3</sup> Mandati i parë i Komisionit përfundoi më 18 gusht. Marrëveshja e 30 gushtit 2006 midis PD-së dhe PS-së parashikoi rifillimin e punës. Më 4 shtator Kuvendi zgjati mandatin deri më 15 tetor. Pas dështimit të zgjatjes së parë, u miratua një zgjatje e dytë deri më 31 tetor, që u zgjat për një herë të tretë dhe të fundit deri më 14 nëntor 2006.



## C. Administrimi i zgjedhjeve

Ka një sërë hapash që janë të domosdoshëm për organizimin e zgjedhjeve vendore. Këto hapa do të kërkonin pjesëmarrjen/bashkëpunimin e opozitës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për disa aspekte që kanë të bëjnë me administrimin e zgjedhjeve.

### 1. Regjistrimi i zgjedhësve

Që nga miratimi i një pakete me pjesë të reja legjislacioni me qëllim reformimin e procesit të regjistrimit të zgjedhësve në janar 2005, autoriteteve të qeverisjes vendore u janë dhënë të gjitha përgjegjësitë në lidhje me hartimin e listave të zgjedhësve në bazë të informacionit nga regjistrat e gjendjes civile. Ky ka qënë një zhvillim i mirëpritur, pasi është qeverisja vendore ajo që mban regjistrat me të dhënat e gjendjes civile të popullsisë. Autoriteti qendror, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC), në Ministrinë e Brendshme, ka për detyrë të nxjerrë udhëzime ose urdhra mbi metodologjinë që do të përdoret për hartimin e listave të zgjedhësve, të kontrollojë të dhënat e marra nga qeverisja vendore si dhe të këshillojë NjQV-të mbi gabimet e mundshme, duke përfshirë edhe rekordet e shumëfishta.

Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005 rekomandon adoptimin e një sistemi të listave të zgjedhësve që të lidhet me krijimin e një sistemi tërësisht funksional të regjistrimit të popullsisë, i cili të mundësojë, para çdo zgjedhjeje, nxjerrjen e listave të zgjedhësve nga regjistrat e kompjuterizuar dhe të përditësuar të gjendjes civile, të mbajtura në zyrat e gjendjes civile të njësisve të qeverisjes vendore.

Krijimi i një sistemi të tillë të regjistrimit të popullsisë është penguar deri tani nga një sërë çështjesh, ku përfshihen mungesa e një sistemi funksional adresash të ndërtesave, mungesa e dokumentave të reja të identifikimit, migrimi i vazhdueshëm dhe shpesh i paraportuar, dhe deri diku kapacitetet e kufizuara të administratës vendore.

Duke marrë parasysh se krijimi i një sistemi të tillë kërkon kohë dhe nuk mund të përfundojë midis zgjedhjeve të korrikut 2005 dhe zgjedhjeve vendore të dimrit 2006-2007, Raporti Përfundimtar rekomandon një përjasje më afatgjatë. Në fakt, ndërkohë që qeveria e re u tregua e gatshme për të filluar punën në lidhje me çështjen e adresave dhe gjëndjen civile menjëherë sapo erdhi në pushtet, ishte e qartë se e gjithë iniciativa nuk mund të përfundonte për zgjedhjet vendore, dhe për të qënë më realistë u zgjodh një përjasje më afatgjatë.

Si rezultat, në vend të një sistemi të vetëm të bashkuar të proceseve të gjendjes civile/regjistrimit të zgjedhësve, u hartuan dhe zbatuan paralelisht dy procese:

- hartimi i listave të zgjedhësve për zgjedhjet vendore;
- dhe objektivi afatgjatë për ta pajisur Shqipërinë me një sistem tërësisht funksional të gjendjes civile, nga i cili do të nxirreshin listat e zgjedhësve duke filluar me zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2009.

Përsa i përket projektit afatgjatë për gjendjen civile, midis Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë dhe OSBE/ODIHR-it u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi për dhënien e “ekspertizës për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile”. Projekti gëzon mbështetjen si të shumicës ashtu dhe opozitës.

Për këtë arsye, një nga çështjet e para në kalendarin e punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore ishte përgatitja e listave të zgjedhësve për zgjedhjet e ardhshme vendore. Në mungesë të një sistemi tërësisht funksional të gjendjes civile, u ra dakord që listat e zgjedhësve të zgjedhjeve të vitit 2005 duhet të shërbenin si bazë për hartimin e listave që do të përdoren në zgjedhjet vendore.

Me qëllim hartimin dhe përditësimin e listave për zgjedhjet vendore, u desh të zbatohet një proces me dy nivele:

- si hap i parë, regjistrat e gjendjes civile që janë burimi i vetëm për hartimin e listave të zgjedhësve duheshin ”korrigjuar” nga kryetarët e NjQV-ve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGjC) në Ministrinë e Brendshme;
- hapi i dytë do të zbatohet në nivel vendor, kur kryetarët e NjQV-ve do të merrnin nga DPGjC-ja Listat Paraprake të Zgjedhësve (bazuar në listat e zgjedhësve të vitit 2005), do t’i përditësonin ato për NjQV-në përkatëse, dhe do të pasqyronin në listat e zgjedhësve korrigjimet e bëra në regjistra.

#### “Korrigjimi” në regjistra dhe bashkëpunimi midis nivelit qendror dhe atij vendor:

DPGjC-ja, e cila disponon pajisjet kompjuterike me të gjitha listat e zgjedhësve të korrikut 2005, duhej të punonte së bashku me kryetarët e NjQV-ve, të cilët kanë përgjegjësinë kryesore për hartimin e listave të zgjedhësve, për zgjidhjen e tre çështjeve të evidentuara në listat e zgjedhësve të vitit 2005: së pari, rastet e mbetura të zgjedhësve të pamentifikuar (të ashtuquajturat “rastet me kodin 999”), së dyti, rastet e mundshme të mbetura të rekordeve të shumëfishta, dhe së fundi, çështja e situatës së zgjedhësve që kanë qenë të regjistruar nga një “regjistër i përkohshëm”.

Diskutimet midis shumicës dhe opozitës në lidhje me procedurat e këtij procesi përditësimi janë ndërprerë vazhdimisht, veçanërisht në lidhje me çështjen e zgjedhësve të cilët u regjistruan në listat e zgjedhësve të vitit 2005 nga një “regjistër i përkohshëm” në vënd të një “regjistri themeltar”.

Mosmarrëveshja midis qeverisë dhe opozitës në lidhje me këtë çështje u bë veçanërisht e dukshme në maj 2006, kur:

- Opinioni i Ministrisë së Brendshme ishte përdorimi si bazë i listave të zgjedhësve të vitit 2005 dhe përditësimi i tyre duke përdorur si Regjistrin Themeltar (RTh) ashtu edhe Regjistrin e Përkohshëm (RP) të mbajtur në Zyrat e Gjendjes Civile në njësitë e qeverisjes vendore;
- Pozicioni i Partisë Socialiste dhe aleatëve të saj ishte që përdorimi i Regjistrave të Përkohshëm ishte një përjashtim në vitin 2005 dhe nuk duhej

përsëritur, pasi, siç deklaroi ata, Regjistri i Përkohshëm lejonte manipulime të tilla si votim i shumëfishtë dhe rritje artificiale të numrit të zgjedhësve.

Çështja u zgjidh vetëm pjesërisht, kur në fund të gushtit 2006, bashkësia ndërkombëtare në Tiranë arriti të ndërmjetësonte një marrëveshje midis forcave politike, e cila, midis të tjerash, përcaktonte se “të gjitha referencat mbi regjistrin e përkohshëm” do të fshiheshin nga Kodi Zgjedhor. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor përsa i përket çështjes së mësipërme nuk ishin miratuar ende, por transferimi i të dhënave të Regjistrave të Përkohshëm pothuajse po përfundonte.

Gjithsesi, duket se është bërë një punë e konsiderueshme nga DPGjC-ja dhe kryetarët e NjQV-ve, duke zgjidhur shumicën, në mos të gjitha, rastet e zgjedhësve në Regjistrat e Përkohshëm.

Në fakt, në maj të vitit 2006, Ministria e Brendshme (MB) nxorri tre udhëzime që kishin për qëllim zgjidhjen e problemeve të evidentuara:

- Udhëzimi nr. 806, datë 3 maj 2006, për rastet e shtetasve me adresë shifrore zgjedhore jo të plotë (“rastet 999”);
- Udhëzimi nr. 807, datë 3 maj 2006, mbi zgjedhësit e regjistruar në regjistrat e përkohshëm;
- Udhëzimi nr. 873, datë 15 maj 2006, mbi dublikatat.

Ndonëse MB-ja ka detyrimin të nxjerrë akte nënligjore (urdhra dhe udhëzime), kryetarët e NjQV-ve luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces. Në fakt, ndërsa sistemi kompjuterik i DPGjC-së është përdorur për evidentimin dhe veçimin e rekordeve të shumëfishta, “rasteve 999” dhe zgjedhësve nga RP-ja, zgjidhja e këtyre çështjeve duhet bërë kryesisht nga kryetarët e NjQV-ve, sipas procedurës së përshkruar në udhëzime. Menjëherë pas nxjerrjes të udhëzimeve, disa nga drejtuesit e Partisë Socialiste u bënë thirrje kryetarëve socialistë të NjQV-ve që të refuzonin zbatimin e tyre. Si rrjedhojë, në disa bashki të drejtuara nga socialistët, kryesisht në Vlorë, disa njësi bashkiake në Tiranë, dhe në Durrës, Fier e Berat, puna filloi vetëm pas nënshkrimit të Marrëveshjes së 30 gushtit.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga DPGjC-ja, janë kryer proceset e mëposhtëm:

- Korrigjimi i dublikatave

Kishte rreth 75 000 dublikata të mbetura në listat e zgjedhësve të përdorura për zgjedhjet e korrikut 2005. Nga momenti i miratimit të udhëzimit nr. 873 të MB-së, numri i tyre është ulur në rreth 58 000.

- Zgjedhës të pidentifikuar (“rastet 999”)

Pas zgjedhjeve të korrikut 2005, në listën e përdorur për ato zgjedhje kishin mbetur rreth 470 000 raste “zgjedhësish me kodin 999”. Nga momenti i zbatimit të udhëzimit nr. 806, numri i këtyre rasteve është ulur në rreth 290 000, të cilat përfshijnë, sipas DPGjC-së,

rreth 30 000 raste ku zgjedhësit janë identifikuar, por ndërtesat ku ata banojnë nuk kanë adresë numerike. Për rrjedhojë, kryetarët e NjQV-ve duhet t'u caktojnë një adresë numerike këtyre ndërtesave. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, kanë mbetur rreth 260 000 raste të "zgjedhësve me kodin 999". Disa bashkëbisedues u shprehën se këto raste mund t'u përkasin shtetasve që kanë emigruar jashtë Shqipërisë.

- Zgjedhës nga Regjistri i Përkohshëm

Regjistrat e Përkohshëm u krijuan gjatë një verifikimi derë më derë në periudhën nëntor 2004 – shkurt 2005. Ata u mbyllën më 28 shkurt 2005 – në atë kohë ata përmbanin 138 000 rekorde – dhe nuk ishin prekur deri në momentin kur filloi të zbatohet udhëzimi nr. 807 (në periudhën maj - shtator 2006, në varësi të bashkive/komunave).

Gjatë periudhës 1 mars 2005 dhe fillimit të zbatimit të udhëzimit nr. 807, rreth 50 000 shtetas, të cilët ishin regjistruar në RP kërkuan regjistrimin e tyre në RTh-të e NjQV-ve të tyre të vendqendrimit aktual. Duke qenë se nuk ekzistonte ndonjë rregullim për të punuar me RP-të deri në nxjerrjen e udhëzimit nr. 807, këta qytetarë gjendeshin njëkohësisht në RP-në dhe RTh-në të NjQV-ve të vendqendrimit aktual. Për këtë arsye, detyra e parë ishte heqja e këtyre 50 000 qytetarëve nga RP-të.

Detyra e dytë, e cila u përcaktua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 603 të shtatorit 2006, ishte zgjidhja rast pas rasti e 80 000 rekordeve të mbetura të shtetasve në RP-të. Këta u kontaktuan nga grupet e punës të dërguara nga zyrat e gjendjes civile të NjQV-ve dhe iu kërkuar të zgjidhnin midis regjistrimit në RTh-në e NjQV-së së vendqendrimit aktual ose të mbeteshin të regjistruar në RTh-në e NjQV-së së origjinës; në rastin e fundit ata do të mund të votonin vetëm në NjQV-në e origjinës.

Sipas të dhënave nga DPGjC-ja, në kohën e vizitës së MVN-së, ishin kontaktuar mbi 99% e 88 000 rekordeve të qytetarëve të mbetur.

Hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë nga kryetarët e NjQV-ve janë reflektimi i të gjitha "korigjimeve" të përmendura më sipër në regjistrat e gjendjes civile, si dhe në pjesën përkatëse të versionit elektronik të listës së zgjedhësve së vitit 2005.<sup>4</sup>

Listat paraprake të zgjedhësve – Baza ligjore

Ndonëse hapat praktikë janë paraqitur më lart, mungesa e një marrëveshjeje midis forcave politike për ndryshimin e Kodit Zgjedhor po pengon çdo punë përgatitore të mëtejshme.

Kodi Zgjedhor përmban dy grupe dispozitash në lidhje me mënyrën e hartimit të listave të zgjedhësve, ku asnjë prej tyre nuk duket të ofrojë një kuadër të mjaftueshëm nëse nuk ndryshohet:

<sup>4</sup> Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të vërë në dispozicion të DPGjC-së 100 kompjutera për të mbështetur këtë proces në nivel NjQV-je. 50 kompjutera të tjerë janë dhuruar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES).

- Neni 64/2 u përfshi si dispozitë kalimtare në Kod para zgjedhjeve të korrikut 2005 specifikisht për ato zgjedhje. Ky nen nuk mund të përdoret për zgjedhjet e ardhshme;
- Nenet nga 50 deri në 64/1 parashikojnë kuadrin e përgjithshëm dhe të përhershëm për hartimin e listave të zgjedhësve për një periudhë afatgjatë mbështetur në regjistrat e gjendjes civile. Këto dispozita parashikojnë një sërë afatesh ligjore për hartimin e listave, të cilat janë shkëlur tashmë ndjeshëm.

Një problem tjetër në këtë rast është se nenet nga 50 deri në 55, përsëri u referohen "regjistrave themeltarë dhe të përkohshëm" ndërkohë që Marrëveshja e 30 gushtit parashikoi "heqjen e të gjitha referencave për regjistrin e përkohshëm në Kodin Zgjedhor".

Edhe nëse ndryshimet e nevojshme do të miratoheshin, koha në dispozicion për hartimin e listave do të përbënte përsëri një sfidë. Në fakt, siç u vu në dukje nga disa bashkëbisedues të MVN-së, me miratimin e këtyre ndryshimeve, kryetarëve të NjQV-ve do t'u duhej të pasqyronin korrigjimet në pjesën e tyre të versionit elektronik të listës së zgjedhësve të vitit 2005. Më pas, listat paraprake të zgjedhësve do të duhej të afishoheshin për rishikim nga publiku dhe të kontrolloheshin në të njëjtën kohë në DPGjC për dublikime të reja të mundshme. Listat përfundimtare të zgjedhësve do të duhej të afishoheshin sërish dhe do të nevojitej një kohë e caktuar për procese të mundshme gjyqësore, korrigjime përfundimtare, shtesa apo heqje nga listat.

Disa bashkëbisedues kanë argumentuar se, duke patur parasysh punën e kryer në vitin 2005 mbi listat e zgjedhësve dhe në vitin 2006 për regjistrat e gjendjes civile, do të nevojiteshin shtatë deri në tetë javë për përfundimin e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet vendore.

## **2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Zgjedhjet e ardhshme vendore do të administrohen nga një administratë zgjedhore me tre nivele: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), rreth 384 Komisione të Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore (KZQV) dhe rreth 4700 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Për herë të dytë në Shqipëri, numërimi i votave do të bëhet në vendet e numërimit.

Aktualisht, KQZ-ja përbëhet nga shtatë anëtarë me mandat shtatëvjeçar. Dy anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, dy nga Presidenti i Republikës dhe tre nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Sipas Kodit Zgjedhor në fuqi, partitë politike gëzojnë ndikim politik të genësishëm mbi propozimet.

Nga shtatë anëtarë, që prej prillit të vitit 2006 ishin tre vende të paplotësuara, përfshirë edhe vendin e Kryetarit. KQZ-së iu desh të funksiononte pa anëtarësinë e plotë për disa muaj për shkak të mosmarrëveshjes midis partive politike në lidhje me procedurën ligjore që duhej ndjekur për propozimin e një prej tre anëtarëve. Propozimi i anëtarëve për

vendet e paplotësuara u përfundua midis datave 29 korrik dhe 1 gusht në një atmosferë polemikash.

Pas caktimit të anëtarit të fundit të KQZ-së nga Presidenti, KQZ-ja nisi funksionimin e saj më 14 gusht. Balancimi në KQZ tani është vendosur në katër me tre, ku koalicioni qeverisës i qendrës së djathtë kontrollon shumicën vepruese. Megjithatë, kërkesa për shumicë të cilësuar për vendimmarrje të rëndësishme 5 nga 7 vota, i siguron PS-së një pakicë bllokuese.

Marrëveshja e 30 gushtit parashikoi rritjen e anëtarësisë së KQZ-së nga shtatë në nëntë anëtarë dhe të dy anëtarët shtesë do të zgjidhen nga Kuvendi, ku Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Demokristiane (PDK) u ftuan të paraqesin së bashku kandidatura për të dy vendet e paplotësuara. Në këtë rast, shumica e thjeshtë në KQZ do të ishte pesë me katër dhe shumica e cilësuar gjashtë me tre. Marrëveshja parashikoi gjithashtu që Zëvendëskryetari i KQZ-së t'i përkasë opozitës.

Për zbatimin e këtyre modifikimeve do të duheshin ndryshime kushtetuese. Këto ndryshime do të duhej të miratoheshin nga Kuvendi me një shumicë prej dy të tretash (Kushtetuta - neni 177). Kushtetuta parashikon gjithashtu se ndryshimet kushtetutese të miratuara nga Kuvendi mund t'i nënshtrohen gjithashtu edhe një referendum me kërkesë të një të pestës së deputetëve. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, një sërë projektndryshimet të propozuara nga PD-ja u miratuan nga Komisioni i Ligjeve, por pritej që të vendoseshin në rendin e ditës së punimeve të Kuvendit për shqyrtim në seancë plenare.

Pavarësisht se ka funksionuar për disa muaj pa anëtarësinë e plotë, KQZ-ja ka mundur të marrë disa hapa dhe të miratojë vendime dhe dokumentet e nevojshme zgjedhore për zhvillimin e zgjedhjeve vendore.

### **3. Komisionet e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore**

Të 384 KZQV-të janë të përbëra nga shtatë anëtarë dhe një sekretar (neni 40 pika 1). Një anëtar propozohet nga partia më e madhe e shumicës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia më e madhe e opozitës parlamentare dhe dy anëtarë propozohen përkatësisht nga partia e dytë dhe e tretë e shumicës parlamentare dhe dy anëtarë nga partia e dytë dhe e tretë e opozitës parlamentare.

Kodi Zgjedhor parashikon tre kritere për emërimin e anëtarit të shtatë midis partive më të mëdha në secilin krah të spektrit politik: ndarje 50/50 mes shumicës dhe pakicës, përzgjedhje e rastësishme dhe shpërndarje e barabartë në të gjithë territorin zgjedhor. Për të përcaktuar se cila parti do të kryesojë secilën KZQV, hidhet short në KQZ nga përfaqësuesit e partive politike. Kjo procedurë nuk është zbatuar akoma për shkak të mungesës së përfaqësuesit të Partisë Socialiste në KQZ. Praktika që përfaqësuesit e partive politike janë përgjegjës për hedhjen e shortit nuk është një kërkesë e Kodit Zgjedhor, por vetëm një traditë e rregulluar me vendim të KQZ-së. Përveç kësaj vështirësie, MVN-ja mësoi se asnjë prej partive politike nuk i kishte paraqitur KQZ-së

listat e propozimeve për anëtarë të KZQV-ve, megjithëse dy partitë e mëdha thanë se i kishin përgatitur listat e tyre.

Duhet theksuar se sipas ligjit KZQV-të duhej të ishin ngritur që prej gushtit 2006 (neni 40 pika 4) Vonesat në propozime ngrejne shqetësimin në lidhje me mundësinë për trajnim të anëtarëve të KZQV-ve dhe aftësinë e tyre për të kryer detyrat e tyre në kohë.

Së fundi, ka patur kërkesa nga partitë e vogla që numri i anëtarëve të KZQV-së të rritet me qëllim përfshirjen e tyre. Kjo do të kërkonte ndryshime në Kodin Zgjedhor. Megjithatë, disa bashkëbisedues kanë shprehur shqetësime lidhur me kapacitetin aktual të partive politike për të propozuar një numër të përgjithshëm prej 40 000 anëtarësh të komisioneve zgjedhore në KZQV, qendrat e votimit dhe vendet e numërimit.

#### **4. Vendet e numërimit**

Në janar të vitit 2005, Kuvendi vendosi të përcaktojë procedurën e numërimit të përqendruar që u zbatua për herë të parë gjatë zgjedhjeve parlamentare të korrikut 2005. Këto procedura parashikojnë që, me përfundimin e votimit, materialet zgjedhore nga secila prej rreth 4700 qendrave të votimit të transportohen në një Vend Numërimi (VN) të përqendruar.

Në formën e tij aktuale, Kodi Zgjedhor parashikon (neni 95/2) se duhet të ketë pesë grupe numërimi me nga shtatë anëtarë për "çdo njësi zgjedhore". Ky format ishte i përshtatshëm kur "njësitë zgjedhore" ishin 100 zona për zgjedhjet parlamentare, që kishin afërsisht të njëjtën madhësi. Në rastin e zgjedhjeve vendore, kjo gjë krijon problem për bashkitë e mëdha, të cilat mund të jenë disa herë më të mëdha sesa zonat për zgjedhjet për Kuvendin, dhe ka nevojë për përshtatje.

Kryetari i KQZ-së e informoi MVN-në se, nëse ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor nuk do të miratoheshin, KQZ-së do t'i duhet të kërkojë mënyra alternative.

#### **5. Certifikatat e lindjes**

Disa bashkëbisedues të MVN-së kanë shprehur shqetësimin se mund të abuzohet me certifikatat e lindjes, të cilat në Shqipëri përdoren shpesh si mjet për të vërtetuar identitetin e një personi. Nga rreth 2,8 milionë zgjedhës të regjistruar, pritet që deri 1,5 milionë prej tyre të votojnë duke përdorur certifikatën e lindjes si dokument identifikimi.

#### **D. Media**

Kodi Zgjedhor rregullon pasqyrimin e fushatës zgjedhore në media. Dispozitat gjejnë zbatim pothuajse ekskluzivisht për median elektronike. Dispozitat për median gjejnë zbatim vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës. Media e shkruar nuk i nënshtrohet ndonjë rregullimi përveç detyrimit për të respektuar periudhën e heshtjes zgjedhore menjëherë para ditës së zgjedhjeve.

Ashtu si në zgjedhjet e fundit, Kodi i kërkon transmetuesit publik t'i sigurojë secilës parti që kandidon në zgjedhje kohë transmetimi falas për fushatë. Shpërndarja e kohës varet nga përmasat e përfaqësimit të partive në Kuvend, ku ato vendosen në një nga tri kategoritë: ato me mbi 20% të vendeve në Kuvend (këtej e tutje të quajtura partitë e mëdha), ato me më pak se 20% të vendeve në Kuvend (këtej e tutje të quajtura partitë e vogla) dhe partitë joparlamentare.

Gjithashtu, si mediave private ashtu edhe atyre publike u kërkohet të pasqyrojnë fushatat e partive në programet e lajmeve, ku koha e transmetimit varet nga pesha e përfaqësimit të partive në Kuvend. Koha në total për çdo parti "të madhe" parlamentare duhet të jetë sa "dyfishi i kohës së transmetimit" që i jepet çdo partie "të vogël" parlamentare. Kodi parashikon qartazi sanksione që zbatohen në rast të mosrespektimit të rregullave.

Media elektronike rregullohet me ligjin e shtatorit 1998 "Për radiot dhe televizionet publike dhe private në Republikën e Shqipërisë". Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) është organi përgjegjës për mbikqyrjen e sjelljes së mediave.

Megjithatë, gjatë periudhës zgjedhore, pasqyrimi i çështjeve të lidhura me zgjedhjet në media, si rregull, monitorohet nga Bordi i Monitorimit të Medias që vepron nën autoritetin e KQZ-së dhe rregullohet me dispozita të veçanta në Kodin Zgjedhor. Roli i KKRT-së në procesin zgjedhor është shumë i kufizuar.

Qeveria ndërmorri një reformë të KKRT-së në fillim të vitit 2006, që shkaktoi një reagim të fortë të opozitës e cila kritikoi atë që ajo e konsideroi si largim nga një përbërje e balancuar dhe akuzoi qeverinë për tentativë të vendosjes së kontrollit total mbi median audio-vizive.

Çështja e mbikqyrjes së medias audio-vizive u kthye në një çështje të rëndësishme debati në muajt pasues, aq sa filloi të ndikonte mbi reformën zgjedhore. Pasi u diskutua, kësaj çështjeje iu gjet zgjidhja në kuadrin e marrëveshjes së 30 gushtit, në bazë të së cilës si KKRT-ja ashtu edhe Këshilli Drejtues i Radios dhe Televizionit (KDRT) do të zgjeroheshin, dhe propozimi i anëtarëve të rinj do të përfshinte në një shkallë të gjërë opozitën. Gjithashtu, marrëveshja parashikonte një shumicë të cilësuar që do të nevojitej në një sërë çështjesh që do të përcaktoheshin nga komisioni parlamentar i medias.

Raportet e mëparshme të MVZ-ve arrinin në konkluzionin se që nga zgjedhjet vendore të vitit 2003 dhe zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005, media ka treguar tendenca pozitive, sidomos në lidhje me përputhjen me kuadrin ligjor dhe raportimin e balancuar. Megjithatë, janë ngritur shqetësime në lidhje me strukturat e pronësisë së shumicës së mediave dhe efektet e kësaj në pavarësinë e tyre, si edhe dobësitë e entit rregullator.

## **E. Pjesëmarrja e grave**

Raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it kanë vënë në dukje se, edhe pse shumë aktive në nivelin bazë të politikës, gratë rrallë herë përzgjidhen si kandidatë dhe arrijnë



pozicione drejtuese në partitë politike. Gratë janë gjithashtu të përfaqësuara në nivelin e duhur në administratën zgjedhore.

#### **F. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe ata vendorë jo-partiakë**

Kodi Zgjedhor (neni 18) përcakton së të drejtën për të caktuar vëzhgues e kanë *“organizatat jo-qeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias”*. Përveç tyre, partitë politike të regjistruara në KQZ dhe kandidatët e pavarur në zonat e tyre përkatëse mund të caktojnë nga një vëzhgues për çdo KZQV, qendër votimi dhe vend numërimi. Prania e vëzhguesve në KZQV, qendrën e votimit dhe vendin e numërimit është e kufizuar në dy persona për çdo organizatë, OJF ose konkurent në zgjedhje.

Të gjitha palët vëndase të takuara kërkuan që OSBE-ja të sjellë një numër shumë të madh vëzhguesish si në ditën e zgjedhjeve ashtu edhe përgjatë procesit zgjedhor.

Përsa i takon vëzhgimit vendas, pritet që tetë grupe vëzhguesish vendas të dërgojnë vëzhgues vendas në rreth 2600 qendra votimi, me mbështetjen e Institutit Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare të SHBA-së (NDI). Ata mendojnë të arrijnë të vëzhgojnë numërimin në vendet e numërimit të 200 NjQV-ve më të populluara.

#### **IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

MVN-ja e OSBE/ODIHR-it rekomandon krijimin e një Misioni të plotë të Vëzhgimit të Zgjedhjeve për të vëzhguar zgjedhjet e ardhshme vendore në Republikën e Shqipërisë. Përveç një grupi kryesor ekspertësh, misioni duhet të përfshijë 30 vëzhgues afatgjatë që do të shpërndahen në të gjithë Republikën e Shqipërisë për të ndjekur fushatën dhe përgatitjet zgjedhore. Gjithashtu, konsiderohet i nevojshëm caktimi nga shtetet pjesëmarrëse i 400 vëzhguesve afatshkurtër për të ndjekur procedurat e ditës së votimit dhe numërimin.

## SHTOJCA 1



### Zyra për Insitucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

#### Misioni i Vlerësimit të Nevojave

#### Programi (6 – 8 nëntor 2006)

##### E hënë, 6 nëntor

- Prezantim i shkurtër me Zëvendëskryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, z. Alex Finnen dhe stafin e Prezencës në Shqipëri
- Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme, z. Besnik Mustafaj
- Takim me Zëvendësministrin e Brendshëm, z. Ferdinand Poni
- Takim me kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Çlirim Gjata

##### E martë, 7 nëntor

- Takim me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorin Pavel Vacek
- Mëngjes pune me Ambasadoren e Shteteve të Bashkuara, znj. Marcie B. Ries
- Takim me Kryeministrin, Dr. Sali Berisha
- Takim me Kryetarin e Partisë Socialiste, z. Edi Rama
- Takim me anëtarët e KQZ-së
- Takim me Grupin e Punës për Zgjedhjet
- Takim me bashkëkryetarin nga Partia Demokratike në komisionin e posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore, z. Bujar Nishani
- Takim me partitë e shumicës parlamentare (PR, PDR, PDK, PAA, PBDNJ, PBLD)

- Takim me partitë opozitare parlamentare (PSD, LSI, PAD, PDS)

### **E mërkurë, 8 nëntor**

- Takim me bashkëkryetarin nga Partia Socialiste në komisionin e posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore, z. Ben Blushi
- Takim me ambasadorët e Bashkimit Evropian
- Takim me OJF-të vendase vëzhguese të zgjedhjeve (z. Kristaq Kume nga INSIZ, znj. Vasilika Hysi nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, znj. Gerta Meta nga Shoqata për Kulturë Demokratike)
- Takim me Drejtorin e Përgjithshëm të DPGjC-së, z. Eduart Aliko
- Takim me Këshilltarin Ligjor të Presidentit të Republikës, z. A. Metani
- Takim përmbyllës me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorin Pavel Vacek

## RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, shtetit të së drejtës dhe për të promovuar parimet e demokracisë dhe (...) për të ndërtuar, forcuar dhe mbrojtur institucionet demokratike, si dhe të promovojë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Helsinkit 1992).

ODIHR-i, me seli në Varshavë, Poloni, u krijua si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit të vitit 1990 dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të gjerë për të përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot, për të punojnë mbi 100 vetë.

ODIHR-i është institucioni kryesor në Europë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve çdo vit për të vlerësuar nëse zgjedhjet në zonën e OSBE-së janë në përputhje me legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare. Metodologjia unike siguron një vështrim në thellësi të të gjithë elementëve të një procesi zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, ODIHR-i ndihmon shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë fushat tematike të mëposhtme: shteti i së drejtës, mbështetja ligjore, qeverisja demokratike, migrimi dhe liria e lëvizjes dhe barazia gjinore. ODIHR-i zbaton një numër programesh të caktuara asistence çdo vit, që kanë si qëllim të mbështesin dhe të rrisin përmbushjen nga shteti të angazhimeve të OSBE-së si dhe të zhvillojnë strukturat demokratike.

ODIHR-i monitoron shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e angazhimeve të OSBE-së lidhur me dimensionin njerëzor dhe ndihmon në përmirësimin e **të drejtave të njeriut**. Gjithashtu, ai organizon disa takime çdo vit për të rishikuar zbatimin e angazhimeve të OSBE-së lidhur me dimensionin njerëzor nga shtetet pjesëmarrëse.

Në fushën e **tolerancës** dhe **mos-diskriminimit**, ODIHR-i u ofron mbështetje shteteve pjesëmarrëse në zbatimin e angazhimeve të OSBE-së dhe në forcimin e reagimit të tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, anti-semitizmit dhe formave të tjera të intolerancës. Aktivitetet e ODIHR-it në lidhje me tolerancën dhe mos-diskriminimin janë përqëndruar në fushat e mëposhtme: legjislacion; trainimet për zbatimin e ligjit; monitorimi; raportimi dhe ndjekja në vazhdimësi të reagimeve ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve; si dhe aktivitetet edukuese për nxitjen e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

ODIHR-i këshillon shtetet pjesëmarrëse mbi politikatat e tyre për komunitetet **rome dhe sinti**. Zyra nxit rritjen e kapaciteteve dhe lidhjen në rrjet mes komuniteteve rome dhe sinti, dhe nxit pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në organet politikëbërëse.

Zyra shërben gjithashtu si institucion qendror për shkëmbimin e informacionit mbi çështjet rome dhe sinti midis aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe misionet në terren të OSBE-së, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it ([www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)).